

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "B & M CONSTRUCTION" SHPK

AKT THEMELIMI

I

Shoqerise Tregtare Me Përgjegjesi Te Kufizuar
"B & M CONSTRUCTION" shpk

Themeluesit qe firmosin me poshte:

Z.Bashkim LIKA i biri i Eqerem-it lindur me 04.07.1970 në Tirane dhe banues në Tiranë Rr."Qemal Stafa" madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me numër personal: H 00704107 S,

dhe

Z.Maklen MICI i biri i Seit-it lindur me 29.01.1979 në Tirane dhe banues në Tiranë Rr."naim Frasheri" madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me numër personal:H 90129109 M.

Qe ne vijim do te perbeje **Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.**

Sot me date 01.03.2023 bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, vendos te themelojne Shoqerine me Përgjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

KREU 1

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i Shoqerise

Shoqeria do te ushtroje veprimtari me objekt:

Ndërtime, rikonstruksione, projektme te ndryshme dhe mirëmbajtje të gjitha fushave dhe të gjitha llojeve, veprimtari industriale dhe tregtare, investime dhe financime në të gjitha fushat, veprimtari importi eksporti, konsulence dhe ndërmjetësime të të gjitha llojeve, veprimtari transportuese, marrje dhe dhënie me qera të pasurive dhe objekteve të ndryshme, veprimtari studimore projektuese dhe supervizioni të ndryshme.

Veprimtari ndërtimore, rikonstruksione dhe mirembajtje në fushën e ndërtimit, përfshirë ndërtime civile, rrugë ura, porte, vepra arti, tunele, ndërtime ushtarake, aeroporte, ndërtime industriale, objekte kulturi, kulturore, sportive, spitale, hotele, banesa, ndërtime hidroteknike dhe turistike, kampingje, parqe rekreative, shtëpi pushimi, palestra, kënde sportive etj. Veprimtari prodhuese të materialeve të ndërtimit, paisje dhe të makinerive, përfshirë prodhimin e inerteve, rërë, zhavor, konglomerate bituminoze, parafabrikate, konstruksione ndërtimore betonarme, druri metalike, llaç e betone te markave të ndryshme, prodhime gurë gelqere e çakull.

Veprimtari transportuese ku përfshihet transporti nacional internacional i mallrave dhe i njerzve për vete dhe të tretë, për import eksport. Ushtrimi i veprimtarise ne fushen turistike,

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "B & M CONSTRUCTION" SHPK

hapje te agjensive turistike te udhetimit per transportin tokesor, detar dhe ajror.
Veprimtari ne fushen e kembimit valutor dhe argjendari.

Tregtim i te gjitha llojeve te pajisjeve elektronike dhe ato informatike. Import-Eksport, tregtimi me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem te pajisjeve elektronike. Projektim,zbatime,kolaudime,supervizione ne fushat elektronike. Projektim, implementim, mirembajtje dhe administrim te platformave Software, Hardware dhe te pajisjeve te sigurise. Riparime te pjeseve te pajisjeve elektronike. Hartim projektesh, dhenie asistence teknike, tregtim te materialeve dhe imputeve te ndryshme te pajisjeve elektronike. Instalim sistemesh te ndryshme elektronike.

Veprimtari eksportuese dhe importuese, ku përfshihet eksporti i lendeve të para dhe i mallrave të përpunuara, si dhe importimi i të gjitha llojeve të mallrave dhe materialeve. Veprimtari tregtare, përfshirë tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore dhe industriale, ndërtimore, elektrike, elektronike bujqësore blektorale, tekstile, hidrosanitare, makineri dhe aparatura, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Veprimtari komisionere, konsulencë në fusha të ndryshme, ndërmjetësime, koperime, përfaqësime dhe tranzitime, shërbime të llojeve të ndryshme. Veprimtari studimore dhe projektuese në fusha të ndryshme të ekonomise, ndërtimore, mekanike, elektrike etj. Veprimtari investuese dhe financuese ku shoqëria do të përdorë për këtë qëllim fonde të saj si dhe fonde të institucioneve financiare dhe bankare vendase dhe të huaja, private dhe publike. Marrje dhe dhënie me qira objekte dhe mjete, paisje dhe zyra, ambiente te ndryshme, pasuri të luajshme dhe të paluajtshme. Veprimtari te ndryshme agrare dhe blektorale.

Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve.



Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

- 1.Ortaket themelues vendosin qe shoqerine ta emertojne" "B & M CONSTRUCTION" shpk
2. Selia Juridike e Shoqerise ndodhet ne Adresen: Rruga e Dibres, , Hyrja 1/1, Kati 2, ZK 8360, Nr. Pasurise 37/151-N.1, vol.13, fq.78. Tirane.
3. Shoqeria mund te krijojë dege, zyra perfaqesimi e filiale brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3

Regjimi Juridik



AKTI I THEMELIT I SHOQERISE "B & M CONSTRUCTION" SHPK

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
2. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
3. Shoqeria do te kete vulen e saj.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Asamblese se Pergjithshme

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata te cfaredo lloj natyre ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri dhe/ose ne ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi dhe/ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj themeltar dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

KOHEZGJATJA


Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar.

KREU III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar eshte 1 000 000 (njemilion) Leke dhe zoterohet 50% nga ortaku Bashkim LIKA dhe 50% nga ortaku Maklen MICI.

KREU IV ORGANET E SHOQERISE



Page 3

**AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "B & M CONSTRUCTION"
SHPK**

Neni 7

Vendimet ne shoqeri merren nga Asambleja e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise, eksperti kontabel i autorizuar dhe drejtuesi teknik caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

**KREU V
ADMINISTRIMI**

Neni 8

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkangjitet ketij Akti.

**KREU VI
DISPOZITA TE TJERA**

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i ndahet Ortakut te shoqerise sipas pjeseve kontribuese ne kapitalin themeltar.
2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

Bashkim LIKA



Maklen MICI

